Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE
Nr._____. Data: 31/01/2025.
Mitrovicë Veriore.

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA MITROVICA E VERIUT/OPSTINA SEVERNA MITROVICA
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY
Njesia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 10
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 10-030/01-000124
Nr. i faqeve / Br. stranica / No pages: 5
Data / Datum / Date: 31/01/2025

RREGULLORE KOMUNALE NR. 01/2025
PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE

Janar 2025, Mitrovicë Veriore

Në bazë të nenit 10, nenit 12 paragrafi 2 pika 'c' si dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 'a' të **Ligjit Nr. 03/L-040** për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës **Nr. 10-030/01-0007269/24** të datës **28.06.2024**, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 31/01/2025 miratoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE

Neni 1
Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve, aktivitetet sportive të klubeve të regjistruara në Federatat gjegjëse, manifestimeve të ndryshme të kulturës, tubimeve partiake, revistave, rekreacionit si dhe grupeve të tjera joformale.

Neni 2
Përkufizime

a). **"DKRS"** nënkupton Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
b). **"Objekti Sportiv"** nënkupton objektin ku ndodhen zhveshtoret, restauranti, hapësirat teknike dhe logjistike, fusha e sportit dhe fusha sportive me të gjitha pajisjet mbështetese.

Neni 3
Fushëveprimi i rregullores

Kjo rregullore njofton, definon dhe rregullon këto çeshtje;

a) Definon funksionet e hapësirave sportive.
b) Definon kush janë palët që kanë të drejtë të shfrytëzojnë objektet sportive.
c) Definon se cilat janë kushtet që duhet të plotësohen nga palët për shfrytëzimin e objekteve sportive.
d) Definon përgjëgjësit që kanë palët për shfrytëzimin e këtyre objekteve.
e) Definon mënyrën e sponsorizimit dhe reklamimit në objektet sportive.
f) Rregullon çmimet për shfrytëzimin e hapësirave të objekteve sportive.

Neni 4
Funksioni i Objekteve Sportive

4.1 Funksioni primar i objekteve sportive është që të krijoj kushte për zhvillimin e aktivtiteteve sportive, rekreative, koncerte, tubime, dhe ngjarje të organizuara ekonomike.
4.2. Në palestër mund të zhvillohen ndeshje dhe stërvitje të sporteve të cilat janë të përshtatshme vetëm për ambiente të mbyllura si: Basketboll, Hendboll, Volejboll, Futsall, si dhe sportet e tjera të licencuara.
4.3. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete të tjera sportive të cilat vlerësohen si jo të rrezikshme për dëmtimin e dyshemesë dhe ambienteve të tjera.
4.4. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete promovuese dhe tubime të fushave politike.

Neni 5
E drejta për shfrytëzimin e Palestrës sportive

Të drejtë shfrytëzimi të palestrës sportive kanë: Institucionet shtetërore, klubet sportive, organizatat politike, organizatat jo qeveritare, organizatat qeveritare, bizneset, institucionet shkollore, Universitetet, Institucionet ndërkombëtare, grupe të tjera formale dhe joformale.

Neni 6
Mënyra e shfrytëzimit të palestrës sportive

6.1. Mënyra e shfrytëzimit të palestrës së sporteve rregullohet me anë të marrëveshjes së arritur të palës së interesuar me menaxherin e objektit të palestrës sportive, e cila nënshkruhet nga menagjeri i palestrës dhe pala e interesuar.

6.2. Pala e interesuar për shfrytëzim të palestrës duhet të paraqes kërkesë së paku 3 ditë para mbajtjes së aktivitetit.

Neni 7
Rregullat themelore për shfrytëzimin e objekteve sportive (rendi shtëpiak)

1. Për pakënaqësitë eventuale, shfrytëzuesi duhet të drejtohet me ankesë në DKRS.
2. Menaxheri i palestrës ka të drejtë të suspendoj përkohësisht shfrytëzuesin e sallës për mos respektimin e rregullorës deri në një vendim tjetër të DKRS-së.
3. Shfrytëzuesi i palestrës duhet të identifikohet dhe të regjistrohet çdo herë para shfrytëzimit të palestrës dhe duhet të respektoj orarin e caktuar në marrëveshje me personat përgjegjës në Palestër.
4. Ndalohet pirja e duhanit në brendësi të palestrës, në të gjitha pjesët e saj.
5. Pas shfrytëzimit të hapësirave në palestër dhe zhveshtore, dorëzimi i gjendjes bëhet te kujdestarët pas verifikimit të hapësirave të shfrytëzuara nga shfrytëzuesi i objekteve sportive.
6. Klubet dhe individët duhet të kujdesen vet për gjërat e tyre personale. Menaxhmenti në Palestër nuk e merr përgjegjësinë për gjërat e humbura në palestër.
7. Shfrytëzimi i palestrës bëhet me pagesë sipas tarifës së caktuar me këtë rregullore, përjashtimisht subjektet e liruara nga pagesa.
8. Pajisjet që përdoren në palestër nga sportistët duhet të jenë të përshtatshme me ambientin e palestrës. Përjashtohen rastet kur ka ndonjë marrëveshje të posaçme me DKRS.
9. Ndalohet hyrja në parket me këpucë të pa pastërta që lënë gjurmë.
10. Shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektin sportive është e ndaluar.
11. Klubet sportive duhet të sjellin orarin e tyre për shfrytëzimin e palestrës te menaxheri i objektit sportiv.
12. Fëmijët nën moshën 16 vjeçare duhet të jenë të përcjellur nga prindërit ose kujdestari i tyre.
13. Ndalohet hyrja me kafshë në palestër, përjashtohet rasti ku kafsha është ndihmë e personit me aftësi të kufizuara.
14. Në zhveshtore nuk lejohet asnjë lloj konsumi i pijeve alkoolike, pijeve me ambalazh qelqi, kurse lejohen pijet freskuese të lojës.
15. Ndalohet hyrja me armë, (përjashtim bëhet vetëm për personat e autorizuar të sigurisë në detyrë).
16. Ndalohet hyrja në palestër me bicikleta, skateboard apo çfarëdo mjeti tjetër transportues, përjashtimisht personat me aftësi të kufizuara.
17. Ndalohet ngjitja e posterëve dhe njoftime tjera pa lejen me shkrim të menaxherit të palestrës.

Neni 8
Vendosja e reklamave

8.1. Subjekteve të interesuara ju mundësohet vendosja e reklamave të tyre me këto dimenzione dhe tarifa mujore:

8.1.1 Në qendrën e fushës së basketbollit-futbollit në parket.....150 €
8.1.2 Në gjysmërrethin e rektit të fushës së basketbollit-futbollit.....50 €
8.1.3 Në hapësirën e 7-metërshit të fushës së futbollit .....2X 0.60m.....50 €
8.1.4 Në hapësirën brenda fushës së basketbollit dhe hendbollit.....2 X 0.60m.....50 €

8.1.5 Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit.....3 X 0.60.m.....40 €
8.1.6 Në pjesën anësore (veriore dhe Jugore; në Muri) të palestrës.. 3 X 0.60m.....40 €
8.1.7 Në pjesët tjera të palestrës dimensioni..... 2 X 0.60m.....20 €
8.2. Kohëzgjatja e vendosjes së reklamës në vendin e zgjedhur do të jetë deri në një vit, me të drejtë vazhdimi përmes kontratës së re.
8.3. Vendi i vendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të kontratës.
8.4. Shpenzimet e shkrimit, vendosjes dhe zhvendosjes së reklamës i bartë subjekti i cili e ka vendos reklamën.
8.5. Pagesa për reklamën e ekspozuar bëhet çdo muaj dhe atë në fillim nga data 1-5 të muajit vijues.
8.6. Në palestrën e sporteve, klubet mund të ekspozojnë reklamat lëvizëse të sponzorëve të tyre vetëm gjatë oratit të ndeshjeve të tyre por me kusht që mos të pengohen reklamat ekzistuese në palestër.
8.7. Në rastet kur paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklamë në të njëjtin vend, përzgjedhja do të bëhet me licitacion.
8.8. Palët që vendosin reklamat janë përgjegjës për dëmet eventuale që shkaktohen gjatë vendosjes dhe heqjës së reklamave dhe obligohen që t'i marrin përsipër të gjitha shpenzimet për riparimin e nevojshëm.

Neni 9

Kushtet dhe Përgjegjësit për shfrytëzuesit e objekteve sportive

9.1. Klubet e interesuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të rregullta sportive duhet t'i deponojnë te menaxheri i palestrës, dokumentet si vijon:

9.1.1 Certifikatën e regjistrimit
9.1.2 Certifikatën fiskale
9.1.3 Lejen e njoftimit të personit përgjegjës
9.1.4 Përgjegjësin e klubit
9.1.5 Listën e antarëve (lojtarëve) të klubit.
9.2. Klubet e regjistruara dhe menaxheri i palestrës pas shqyrtimit të kërkesës së klubit lidhin marrëveshje për shfrytëzimin e palestrës sportive.
3. Subjektet tjera që nuk janë klube sportive të regjistruara, për shfrytëzimin e palestrës sportive duhet të paraqesin kërkesën për shfrytëzimin e palestrës.

Neni 10

Pagesat për shfrytëzimin e objekteve sportive

10.1 Të gjitha klubet që janë të regjistruara në DKRS, respektivisht që janë të licencuara në federatat gjegjëse, apo garojnë në kuadër të federatave përkatëse e që janë nga komuna e Mitrovicës Veriore, mund ta shfrytëzojnë palestrën e sporteve për stërvitje dhe garim në bazë të një orari të rregullt të rregulluar nga përgjegjësi i Palestrës në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre klubeve dhe të vërtetuara nga DKRS, sipas këtyre pagesave,(kritere):

10.1.1 Për stërvitje sportive ---------- pa pagesë, (për një orë)
10.1.2 Për ndeshje zyrtare si vendas ---------- pa pagesë.
10.1.3 Për grupet formale dhe jo formale komunale.....15 € për një orë pa ndriçim, 20 € me ndriçim.
10.1.4 Për stërvitje të klubeve private ----------10 € pa ndriçim, 15 € me ndriçim (për një orë)
10.1.5 Për zhvillimin e ndeshjes pa bileta ----------30 € (për një orë)
10.1.6 Për zhvillimin e ndeshjes me bileta ----------20 % nga mjetet e inkasuara të biletave.
10.1.7 Të gjitha klubet sportive që nuk janë të komunës së Mitrovicës Veriore, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara të shfrytëzojnë palestrën sportive në Komunën e Mitrovicës Veriore duhet të paguajnë 100 € për një orë.

10.1.8 Garat komunale, regjionale dhe republikane të organizuara nga shkollat e komunës së Mitrovicës Veriore apo Drejtoria Komunale e Arsimit lirohen nga pagesa e shfrytëzimit të palestrës së sportit.
10.2 Palestra e sporteve mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të ndryshme sipas këtij kompenzimi:
10.2.1 Për ngjarje komerciale (panaire, revy, ekspozita, dhe të ngjashme) –100 € (për një ditë)
10.2.2 Për ngjarje humanitare-gratis
10.2.3 Për koncerte 30 % nga inkasimi i mjeteve prej biletave ose pagesa fikse sipas marrëveshjes.

Neni 11
Masat ndëshkuese

11.1 Ndaj palëve të cilat nuk i respektojne rendin shtëpiak dhe nuk i binden menaxhmentit të objektit sportiv do të merren masa ndëshkuese, suspendim i përkohshëm për të drejtë shfrytëzimi të palestrës, me kohëzgjatje të lirë për tu përcaktuar nga Përgjegjësi i Palestrës dhe nëse përsëritet më shumë se dy herë i njëjti veprim, atëherë i merret e drejta për shfrytëzim përgjithmonë, derisa organizata ose klubi në fjalë është e përberë nga të njëjtit akterë.

11.2. Për dëmet eventuale të shkaktuara nga klubet apo subjektet tjera përkatëse, përgjegjësia bie të shfrytëzuesi i cili e ka shkaktu dëmin, andaj kompenzimi duhet bërë në afatë prej pesë (5) ditëve në gjirollogarinë bankare të Komunës së Mitrovicës Veriore.

11.3. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hok prej tre antarëve i emëruar nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Në rast të moskompenzimit të dëmeve në afatin e paraparë kohor, procedura e kompenzimit do të vendoset përmes organeve gjyqësore, përmbaruesit privat përfshirë kamatën ligjore si dhe ndalesën për shfrytëzuesin deri në zgjedhjen e kontestit.

Neni 12
Dispozitat Kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret e mëparshme.

Neni 13

Për zbatimin e kësaj rregullore kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, kurse për implementimin e saj kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni 14

Kjo rregullore, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqën e Komunës.

Mitrovicë Veriore

Nedzad UGLJANIN

Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës Veriore

Dorëzohet:
1x1 Kryesuesit të Kuvendit
1x1 MAPL
1x1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha Drejtorive

02 03
683/2025
18.02.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Kryetar i Komunës së – Mitrovicës Veriore Kryesuesi e KK- Mitrovicës Veriore
Kopje:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Bislim Bislimi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Nga:	Mehdi Uka, U.D. Drejtor i Departamentit Ligjor në MKRS Datë:07.02.2025
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor. 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor.	Hava Makolli, U.D. Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrje dhe Zbatim te legjislacionit në MKRS Behar Mehmeti, Zyrtari hartues i vlerësimit
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Mitrovicës Veriore.
Lloji i aktit:	**RREGULLORE**

I nderuar Kryetar/e,
I nderuar Kryesues/e,

Duke u bazuar Ligjin Nr. 08/L-284 për shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Emri i aktit (vendim, rregullore, statut) **Rregullore Komunale nr. 01/2025 për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive.**

I miratuar më datë: 31.01.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.02.2025
I dërguar për shqyrtim në MKRS-së më datë: 05.02.2025

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se legjislacioni sportiv nuk ndalon një akt të tillë, rrjedhimisht nuk është në kundërshtim me ligjet në fuqi që rregullojnë fushën e sportit në MKRS.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet në dispozicion të Komunës së Mitrovicës Veriore dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.